



Pranimi / Dorezimi Prijemno/Prodato Received/Delivery	04.09.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Organiŕ	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlopja Pislog Appendix	Sasia Kohana Quantity
SEKRETARAT	5933/2023		1/16



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.568/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2047/21 të datës 07.06.2023 të Gjykatës së Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.568/2021 të datës 21.06.2021 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson avokat me adresë

, kundër Vendimit me Nr.Prot: 127 i datës 25.05.2021 të Komisionit Ad Hoc për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.568/2021 e datës 21.06.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.Prot: 127 i datës 25.05.2021 i Komisionit Ad Hoc për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. **NDRYSHOHET** Njoftimi për kandidatët e suksesshëm me numër protokolli 205 i datës 13.05.2019 i shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës për proceduarën e rekrutimit për pozitën Inspektor Tatimor 20 pozita.
- IV. **OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Administratës Tatimore të Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike më datë 20.03.2019 ka lëshuar Autorizim për shpalljen e konkursit nga Administrata Tatimore e Kosovës për pozitën Inspektor Tatimor-INS/230/JP00038303. Administrata Tatimore e Kosovës në bazë të këtij autorizimi, me datë 22.03.2019 ka shpallur konkursin për pozitën, "Inspektor Tatimor" (20) pozita me numër reference INS/230/JP00038303, ndërsa në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, Administrata Tatimore e Kosovës më datë 13.05.2019 me numër protokoli 205 ka publikuar Njoftimin për Kandidatët e Suksesshëm, ndërsa rezulton se ankuesja nuk është kandidate e suksesshëme.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 13.05.2019, me datë 29.05.2019 ka parashtruar ankesë me Nr.prot. 11-06-2318 në Komisionin për Zgjidhje e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhje e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 10.06.2019 ka nxjerr Vendim me Nr.prot. 11-107, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi listen e publikuar të datës 13.05.2019.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me Nr.prot. 11-107 të datës 10.06.2019, brenda afatit ligjor në përputhje me Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 08.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 3053/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.07.2019 me numër protokoli 3118/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa me datë 22.07.2019 me numër protokoli 3259/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 23.08.2019 me numër protokoli 3811/2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 11.03.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2227/19, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 25.03.2021 sipas të cilit ka

aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 23.08.2019, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 08.07.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 20.04.2021 me numër protokollin 1901/2021, ka nxjerr vendim me të cilin ka bërë bashkimin e ankesave të parashtruar nga ankuesit lidhur me zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën "Inspektor Tatimor" njëzetë pozita (20) nga Administrata Tatimore e Kosovës pasi që objekti i ankesave është i njëjtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 05.05.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.216/2021 me të cilin ka shfuqizuar vendimet e nxjerra nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, duke e obliguar të njëjtin ti rishqyrtoj ankesat e ankuesve lidhur me këtë procedurë.

Komisioni Ad Hoc për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës duke vepruar në riprocedurë sipas vendimit A.nr.216/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.05.2021 ka nxjerr Vendim me numër Nr. 11-127 me të cilin ka refuzuar ankesat e ankuesve, ndërsa ankuesja kundër këtij vendimi me datë 21.06.2021 me numër protokollin 3200/2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, me shkresën me numër protokollin 4047/2021 të datës 02.08.2021 ka udhëzuar ankuesen për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 07.06.2023 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2047/21 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtojë dhe të vendos për ankesën A.nr. 568/2021 e datës 21.06.2021 të parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3200/2021 të datës 21.06.2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.2047/21 i datës 07.06.2023 i pranuar në Këshill me datë 12.06.2023 me numër protokollin 4667/2023; Fletëkthesë e datës 02.09.2021; Njoftim me numër protokollin 4047/2021 i datës 02.08.2021; Autorizim nga _____ për _____ i datës 01.06.2021; Vendim i KPMSHCK me numër nr. protokollin 2204/2021 i datës 05.05.2021; Vendim i KPMSHCK për bashkimin e lëndëve me numër protokollin 1901/2021 i datës 20.04.2021; Njoftim me numër protokollin 3811/2019 i datës 23.08.2019; Ankesën me numër të protokollit 3053/2019 të datës 08.07.2019 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendim i Komisionit AD HOC për rishqyrtim të ankesave sipas vendimit A.nr.216/2021 të KPMSHCK me numër protokollin 127 i datës 25.05.2021; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA) i ATK me numër protokollin 107 i datës

10.06.2019; Ankesë e drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA) në ATK me numër protokollit 11-06-2318 i datës 29.05.2019; Ankesë/Padi (plotësim) nga F.K.Z. drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 27.01.2021; Ankesë/Padi nga drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 23.09.2019; Dokument Zyra Kombëtare e Auditimit Çështjet për Menaxhmentin e ATK-së për vitin 2019 e muajit Korrik 2020; Konkurs i Jashtëm për pozitën Inspektor Tatimor Njëzetë (20) pozita me Nr. i referencës së pozitës së punës: INS/230/JP00038303 i datës 22.03.2019; Njoftim mbi mbajtjen e intervistës me gojë me numër protokollit 186 i datës 07.05.2019; Njoftim për kandidatët e suksesshëm me numër protokollit 205 i datës 13.05.2019; Pasqyra e llogarisë së trustit e prej datës 01.08.2002-16.06.2021, 1-4 faqe; CV-ja e Diplomë e nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër Nr.480 i datës 10.03.2014; Kopje e vërtetuar nga Noteri . me numër LRP nr.1486/2016; Diplomë e nga Universiteti i Prishtinës me numër Nr.1819 i datës 25.05.2011; Kopje e vërtetuar nga Noteri . me numër LRP nr.1486/2016; Diplomë nga Kolegji Universitar Fama e . me numër Nr.1068/1110 i datës 02.11.2010; Kopje e vërtetuar nga Noteri me numër LRP nr.1486/2016; Letërnjoftim i ; Kërkesë për punësim të përkohshëm nga me numër protokollit 609-23/2017 i datës 30.01.2020; Kontratë për shërbime të veçanta e me numër protokollit 609-24/2017 i datës 30.01.2020; Letër referencë nga zyra e Kryeministrit për . i datës 19.12.2018; Rekomandim nga për i datës 17.10.2017; Referencë e punës nga NSH "Audit Check" për i datës 10.10.2018; Certifikatë nga Raiffeisen Bank për . i datës 12.12.2014; Kontratë Pune nga DZP "Blini" për . i datës 01.09.2008; Certifikatë nga British School për . i datës 24.05.2018; Diplomë nga delf dalf për F.K. i datës 03.12.2007; Certifikatë nga DAAD për i datës 31.01.2014; Diplomë nga shoqata bamirëse e katarit për F.K. i datës 30.03.2002; Certifikatë e kursit të kompjuterëve për .; Certifikatë nga zyra e Kryeministrit për i datës 22.12.2010; Certifikatë nga Raiffeisen Bank për i datës 05.06.2012; Diplomë nga shoqata bamirëse e katarit për i datës 30.07.2002; Certifikatë nga NALRA për e muajit Dhjetor 2006; Certifikatë nga kosma për i datës 11.03.2005; Vërtetim nga Gjimnazi . Skenderbeu për i datës 05.05.2009; Vërtetim nga QKUK për i datës 11.11.2010; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.2227/19 i datës 11.03.2021 i pranuar në Këshill me datë 25.03.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 3118/2019 i datës 15.07.2019; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 3259/2019 i datës 22.07.2019; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 743 i datës 04.04.2019; Miratim për publikimin e rekrutimit të jashtë nga ATK me numër protokollit 171 i datës 20.03.2019; Vërtetim nga Policia e Kosovës për i datës 06.12.2018; Mirënjohje nga OVL-UÇK për i datës 22.01.2018; Mirënjohje nga Kuvendi i Komunës së Drenasit i datës 21.11.2006; Certifikatë nga NALRA për i datës 07.11.2006; Vendim për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve KPSHC-së i ATK-së me numër protokollit 226 i datës 05.04.2019; Testi me shkrim kur nuk kërkohet njohja e gjuhës Angleze i . i datës 30.04.2019; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 2793/2019 i datës 20.06.2019; Miratimi i konkursit nga MAP i datës 20.03.2019; Regjistri i kërkesave të pranuar nga ATK i datës 05.04.2019; Njoftim nga ATK me numër protokollit 230 i datës 08.04.2019; Vlerësimi i kandidatëve për listën e ngushtë për pozitën Inspektor Tatimor i datës 24.04.2019; Njoftimi i kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë i ATK me numër protokollit 260 i datës 25.04.2019; Përgjigje në kërkesë me numër protokollit 214 i datës 14.05.2019; Ankesë e drejtuar Komisionit për shqyrtimin e ankesave në ATK me numër protokollit 11-06-2005 i datës

në ATK i; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 69 e datës 28.03.2019; Letërnjoftim i; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për i datës 30.10.2018; Certifikatë nga FLC për i datës 22.03.2005; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për i datës 22.10.2018; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për me numër Nr.915 i datës 15.06.2010; Kontratë Pune për Kohë të caktuar/ të pacaktuar nga N.T.P. "Bizhuteria" Roni A Gjilan e i datës 02.04.2015; Marrëveshje e veçantë mbi shërbimin nga KQZ për B.M. i datës 04.11.2009; Marrëveshje e veçantë mbi shërbimin nga KQZ për i datës 02.12.2010; Kontratë e veçantë shërbimi nr.-03/11 nga Komuna e Prishtinës për i datës 23.03.2011; Vërtetim nga Komuna e Prishtinës për i datës 01.05.2010; Letër Rekomandim nga MPMS i datës 28.03.2018; Marrëveshje për praktikë në punë nga MPMS për me numër protokollit 51 i datës 29.01.2016; Marrëveshje për praktikë në punë nga MPMS për me numër protokollit 372 i datës 29.07.2016; Marrëveshje për praktikë në punë nga MPMS për me numër protokollit 85 i datës 01.02.2017; Marrëveshje për praktikë në punë nga MPMS-APRK për me numër protokollit 556 i datës 14.02.2017; Pasqyra e llogarisë nga Trusti për prej 01.08.2002-01.09.2018; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 196 e datës 01.04.2019; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për i datës 01.04.2019; Letërnjoftim i Vërtetim mbi kryerjen e aftësisë praktik nga MAP për i datës 02.06.2016; Referencë nga avokati për i datës 25.07.2014; Referencë nga Buna SH.P.K. për; Kontratë Pune nga DPT "Joni" për i datës 07.10.2013; Vërtetim nga DPT "Joni" për i datës 20.10.2016; Kontratë Pune nga DPT "Joni" për i datës 07.10.2014; Vërtetim nga MKK për me numër protokollit 1243/3 i datës 31.05.2013; Deklaratë nga për i datës 18.09.2015; Certifikatë nga Kolegji Iliria për i datës 04.05.2016; Certifikatë nga IGJK për e muajit shtator 2015; Certifikatë nga OAK për i datës 01.07.2017; Certifikatë nga IPSH për i datës 05.05.2009; Diplomë nga Kolegji Iliria për me numër nr.145/15 i datës 18.09.2015; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 282 e datës 02.04.2019; Letër referencë nga N.SH.T. Euro Transport për i datës 25.02.2019; Pasqyra e llogarisë nga Trusti për i datës 01.04.2018-04.04.2019; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë për i datës 29.03.2019; Letër rekomandim nga për i datës 28.03.2019; Letër rekomandim nga I.A. për; Letërnjoftim i Diplomë nga Kolegji AAB për me numër nr.378/16 i datës 19.05.2016; Diplomë e me numër nr.378/16 i datës 19.05.2016; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 348 e datës 03.04.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër nr.4505 i datës 23.07.2014; Certifikatë e martesës e i datës 01.04.2019; Vërtetim për statusin e studentit nga Kolegji Biznesi për i datës 12.01.2017; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Gjakovë për i datës 01.04.2019; Letërnjoftim i; Vërtetim nga NSHT Protechno për e muajit Tetor 2015; Vërtetim nga consulting group për; Vërtetim nga NT "Molika Gas" për i datës 04.05.2018; Letër Rekomandim nga NT "Molika Gas" për H.S. i datës 04.05.2018; Letër referencë nga BM consulting group për; Certifikatë nga IESB për i datës 23.10.2011; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 868 e datës 05.04.2019; Letërnjoftim i; Pasqyra e llogarisë nga Trusti për i datës 01.08.2002-30.01.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e me numër Nr.3175 i datës 10.04.2013; Kërkesa për punësim e A.T. me numër protokollit 85 e datës 29.03.2019; Letërnjoftim i; CV-ja e; Vërtetim nga AlbAudit për i datës 31.08.2016; Vërtetim nga firma Tahiri BI për i datës 02.10.2018; Vërtetim për praktikant nga N.N.SH. "Eco Com" për i datës 19.09.2016; Referencë nga AlbAudit për Vendim mbi emërimin e anëtarëve të komitetit të auditimit nga komuna e Skenderajt i datës 11.01.2018; Vendim mbi emërimin e

anëtarëve të komitetit të auditimit nga komuna e Skenderajt i datës 18.04.2017; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë për i datës 02.10.2018; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë për i datës 27.03.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e i datës 03.01.2013; Kërkesa për punësim e I.O.M. me numër protokollit 699 e datës 04.04.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e I.O. me numër Nr.608 i datës 04.11.2014; Vërtetim kopje nga dokumenti origjinal me numër LRP.Nr. Rendor 2087/2019; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës e me numër Nr.20/16 i datës 17.02.2005; Vërtetim kopje nga dokumenti origjinal me numër LRP.Nr. Rendor 2088/2019; Letërnjoftim i ; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për i datës 04.04.2019; Letër referencë nga . për ; Certifikat nga Raiffeisen bank për i datës 03.11.2016; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 689 e datës 04.04.2019; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për i datës 18.03.2019; Letërnjoftim i ; Diplomë nga Kolegji AAB-Riinvest e me numër Nr.376/12 i datës 06.09.2012; Diplomë nga Kolegji AAB-Riinvest e me numër Nr.357/15 i datës 10.04.2015; Referenc nga Unmik për i datës 14.10.2014; Vërtetim punësimi nga eulex për i datës 14.10.2014; Referencë nga ISPEE për ; Letër Rekomandim nga OTP-ICTY për i datës 09.01.2008; Raporti i vlerësimit të performancës nga eulex për i datës 21.03.2014; Raporti i vlerësimit të performancës nga eulex për i datës 09.10.2014; Letër rekomandim nga studio links 4 për i datës 30.08.2018; Referencë nga eulex për V.A. i datës 18.03.2014; Pagat sipas trustit për prej vitit 2002-2019, 1/3 faqe; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 505 e datës 03.04.2019; CV-ja e L.K.; Letërnjoftim i ; Raporti i vlerësimit të performancës nga për i datës 31.12.2017; Raporti i vlerësimit të performancës nga . për i datës 30.06.2017; Kontratë e punës nga BKTK sh.a. për i datës 21.09.2018; Vërtetim nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për i datës 27.07.2015; Certifikatë nga Afas për i datës 18.06.2014; Certifikatë nga Kolegji Universum për i datës 06.05.2011; Formë e vlerësimit të performancës për praktikantë nga Raiffeisen Bank për 04.09.2014; Certifikatë nga Raiffeisen Bank për i datës 31.08.2014; Letër konfirmim nga BKT për e muajt Prill 2019; Letër motivuese e ; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për me numër Nr.5453 i datës 22.07.2015; Kërkesa për punësim e M.Sh. me numër protokollit 165 e datës 01.04.2019; Diplomë nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" për me numër Nr. 152 i datës 11.02.2019; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prizren për i datës 22.03.2019; Pasqyra e llogarisë nga trusti i M.Sh. i datës 01.08.2002-19.03.2019; Letërnjoftim për M.Sh.; Vërtetim nga Viva Fresh për i datës 22.03.2019; Diplomë nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" për .. me numër Nr. 289 i datës 29.06.2015; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 956 e datës 05.04.2019; Pasqyra e llogarisë nga trusti i i datës 01.08.2002-01.04.2019; Letërnjoftim i ; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Pejë për i datës 03.04.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për . me numër Nr.1992 i datës 04.02.2009; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 203 e datës 02.04.2019; Letërnjoftim i ; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për i datës 25.03.2019; Letër referencë për i datës 29.03.2019; Letër referencë për i datës 02.04.2019; Vendim për emërimin e këshilltarit politik nga MZHI për i datës 01.01.2015; Certifikatë e numrit fiskal nga MEF për e datës 24.11.2009; Certifikatë e regjistrimit nga MTI për "Neë Cafe e datës 14.11.2006; Informata mbi biznesin "Neë Cafe e datës 01.11.2006; Pasqyra e llogarisë së trustit e i datës 30.11.2002-20.03.2019; Kontratë pune nga DPH "AM PM CANTINA" Prishtinë për i datës 10.12.2009; Vlerësim i performancës së të punësuarit nga DPH "AM PM CANTINA" Prishtinë për i datës

01.04.2019; Vlerësim i performancës së të punësuarit nga DPH "AM PM CANTINA" Prishtinë për i datës 01.04.2019; Vërtetim nga ECDL Kosova për i datës 13.11.2008; Letër referencë nga AUK për V.K. i datës 26.03.2019; Diplomë nga Universiteti AAB e V.K. me numër Nr.116/08 i datës 28.06.2008; Kërkesa për punësim e me numër protokollit 773 e datës 05.04.2019; Letërnjoftim i Certifikatë nga Gjykata Themelore Gjakovë e i datës 04.04.2019; Vërtetim nga AAAPARR për me numër protokollit 737/3 i datës 04.04.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e me numër Nr.577 i datës 15.07.2014; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e me numër Nr.1556 i datës 03.11.2010; Certifikatë nga SHKÇAK për e muajit Mars 2016; Certifikatë nga ECDL për i datës 11.02.2015; Certifikatë e datës 20.10.2014 nga "AFAS" për Certifikatën e datës 03.12.2016 nga MASHT për , Referencë me numër protokollit 738/3 e datës 04.04.2019 nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për , Referencë nga Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës- Këshilli i Bashkësisë Islame në Malishevë për Kërkesa për punësim me numër protokollit 927 e datës 05.04.2019 të ; Pasqyra e llogarisë së Trustit të për periudhën 01.08.2003-29.03.2019; Certifikatë e datës 03.04.2019 nga Gjykata Themelore Mitrovicë për Referencën e datës 05.04.2019 nga "PDK" për ; Diplomë me numër 130/12 e datës 01.10.2012 të "Kolegjit Iliria"-Programi Ekonomik-Banka, Financa dhe Kontabilitet për Shkresën me LRP.Nr.Rendor. 4966/2016 nga Noter XH.V. për Pasqyrën e notave me numër 12/5318 e vitit 2020 nga Universiteti i Prishtinës- Fakulteti Ekonomik për ; Kërkesa për punësim me numër protokollit 1066 e datës 05.04.2019 e CV-ja e Diplomë me numër 2543 e datës 18.08.2012 nga Universiteti i Prishtinës -Fakulteti Ekonomik për ; Certifikatë e datës 27.03.2019 nga Gjykata Themelore Mitrovicë për Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile me numër serik. E23377336 i datës 02.04.2019 për Kopjen e letërnjoftimit dhe patent shoferit të) Vërtetimi nga Gjimnazi "Hamëz Jashari"-Komuna Skenderaj për Referencë e datës 27.03.2019 nga Gjimnazi "Hamëz Jashari"-Komuna Skenderaj për Vërtetim me numër 007/2019 i datës 04.04.2019 nga "Call Home Electronics Sh.P.K" për Referencë me numër 008/2019 e datës 04.04.2019 nga "Call Home Electronics Sh.P.K" për Certifikatë e muajit Gusht 2016 nga "EMI" për Certifikatë e muajit Shkurt 2016 nga "EMI" për Kërkesa për punësim me numër protokollit 343 e datës 03.04.2019 të ; Diplomë me numër 5541 e datës 15.09.2015 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Ekonomik për , Certifikatë e datës 29.03.2019 nga Gjykata Themelore Ferizaj për , Kopjen e letërnjoftimit të , Vërtetim i datës 01.04.2019 nga "Sigal Uniqa Group Austria" për Referencë me numër NRF 600914891 nga "FISI CONT SH.P.K"-Ferizaj për , Vërtetim me numër NRF 600914891 nga "FISI CONT SH.P.K"-Ferizaj për ; Pagat sipas trustit prej vitit 2002 deri 2019 të ; Kërkesa për punësim me numër protokollit 1004 e datës 05.04.2019 e ; Kopja e patent shoferit të ; Certifikatë me numër 138/15 e datës 23.11.2015 nga "Shoqata e Bankave të Kosovës" për ; Certifikatën e datës 16.01.2013 nga "NLB" për ; Certifikatë e muajit Shtator 2012 nga "International Bussines College Mitrovica" për ; Certifikatë e datës 24.09.2012 nga "International Bussines College Mitrovica" për Certifikatë e datës 21.07.2014 nga "TEB" për ; Aneksi VII i Kontratës së Punësimit i datës 29.01.2019 nga TEB Bank për ; Aneksi V i Kontratës së Punësimit i datës 31.01.2017 nga TEB Bank për ; Aneksi IV i Kontratës së Punësimit i datës 07.09.2016 nga TEB Bank për Mirënjohje e muajit Maj 2011 nga Parlamenti i Studentëve të Universitetit të Prishtinës për ; Certifikatë e datës 26.04.2012 nga "MDA" për ; Vërtetim i punës praktike i datës 01.07.2013 nga OEFK për K.I; Pagat sipas trustit nga viti 2002 deri 2019 për Diplomë

me numër 2926 e datës 16.01.2013 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik për Formulari i plotësuar i aplikimit me numër protokollit 787 i datës 05.04.2019; Kërkesa për punësim me numër protokollit 787 e datës 05.04.2019 për ; Kopja e pasaportit e ; Kopja e letërnjoftimit e , Certifikatë e datës 03.04.2019 nga Gjykata Themelore Mitrovicë për Letër motivuese e datës 05.04.2018 e Diplomë me numër 5496 e datës 14.09.2015 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Ekonomik për Kartela e studentit me numër ID kartelës: 150501210104 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për ; CV-ja e ; Pasqyra e llogarisë së Trustit e për periudhën 01.08.2002-01.04.2019; Vërtetim për përvojë të punës me numër referencë 004/19 i datës 29.03.2019 nga OJQ "Lëvizja Koha" për , Letër referencë e datës 02.04.2019 nga prof. për ; Referencë me numër 103 i datës 22.10.2014 nga Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Vushtrrisë për Referencë e datës 03.07.2017 nga Drejtori i Bibliotekës "Naim Frashëri" në Vushtrri për Letër referencë e datës 06.11.2015 nga prof. Rr.A. për Certifikatë e datës 02.11.2017 nga "USAID" për Q.U.; Certifikatë nga "Ipko Foundation" për ; Certifikatë me numër amze 1616 i datës 29.07.2017 nga Akademia Profesionale "Elita" për , Certifikatë e datës 19.03.2019 nga "EY" Building a better working world" për ; Certifikatë e datës 14.03.2019 nga "EY" Building a better working world" për ; Certifikatë e datës 21.02.2019 nga "EY" për Certifikatë e datës 25.02.2019 nga "EY" për ; Certifikatë e datës 05.03.2019 nga "EY" për ; Mirënjohje e datës 20.01.2016 nga Komuna e Vushtrrisë për ; Mirënjohje e datës 24.03.2017 nga Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ; Mirënjohje e datës 17.12.2014 nga Komuna e Vushtrrisë për , Mirënjohje e datës 25.04.2013 nga Komuna e Vushtrrisë për Mirënjohje e datës 15.05.2012 nga SHML Gjymnazi "Eqrem Qabej" Vushtrri për ; Mirënjohje e muajit Dhjetor 2015 nga "KVRL"-Vushtrri për ; Certifikatë e muajit Nëntor 2016 nga "GIZ" për , Certifikatë e pjesëmarrjes e datës 09.03.2017 nga "KCSF" për ; Certifikatë nga ILK për ; Certifikatë e datës 22.06.2016 nga "Fole n'Fole" për ; Certifikatë e datës 10.12.2012 nga "PEN" për Q.U; Certifikatë e muajit Mars 2011 nga "Mercy Corps" për Certifikatë e datës 14.12.2010 nga Departamenti i Rinisë/ Projekti i FG i MKRS për Certifikatë e datës 28.01.2011 nga "Kryqi i Kuq i Kosovës" për ; Kërkesa për punësim me numër protokollit 340 e datës 03.04.2019 e ; Certifikatë e datës 02.04.2019 nga Gjykata Themelore Prishtinë për ; Pasqyra e llogarisë së trustit të për periudhën 29.12.2011-04.02.2019; Kopja e letërnjoftimit e ; Letër rekomandim i datës 07.02.2019 nga "Ridea Institute" për ; Referencë e datës 09.03.2018 nga "ETL-Kosova" për ; Letër rekomandim i datës 11.02.2019 nga "Brupharm" për ; Certifikatë e datës 12.04.2013 nga "Yelloë" për Certifikatë e datës 17.08.2015 nga "TED" për ; Certifikatë e datës 22.09.2015 nga "NAS" për ; Certifikatë e datës 12.04.2008 nga "Kursi Intenziv i Gjuhës Angleze" për ; Certifikatë nga "N.T.P KOHA" për ; Diplomë me numër 289/12 i datës 24.12.2012 nga Kolegji "Iliria"-Programi Ekonomik, Banka, Financa dhe Kontabilitet për ; Kërkesa për punësim me numër protokollit 958 e datës 05.04.2019 e D.B.K.; Diplomë me numër 1872 e datës 30.10.2008 nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti Juridik për ; Certifikatë e datës 02.04.2019 nga Gjykata Themelore Prishtinë për , Kopja e letërnjoftimit e ; Ankes i marrëveshjes së punësimit me numër protokollit 1236 i datës 29.12.2009 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës për , Aneks i marrëveshjes i datës 01.11.2006 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Sh.A. për Marrëveshje e punësimit e datës 31.01.2006 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Sh.A. për Letër reference e datës 03.04.2019 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës për Kontratë pune për periudhë të caktuar e datës 02.04.2011

nga Limak Kosovo International Airport J.S.C. për [redacted], Aneksi 1; Letër rekomandim i datës 30.04.2004 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës për [redacted]; Amendament i kontratës së punës për periudhë të caktuar nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës për [redacted]. Formulari i vlerësimit të performancës të punonjësit i datës 01.02.2019 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës për [redacted]; Formularin e vlerësimit të performancës të punonjësit i datës 18.01.2018 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës për [redacted]; Letër referencë e datës 03.04.2019 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës për [redacted]; Kërkesa për punësim me numër protokoll 305 e datës 02.04.2019 e [redacted]; Diplomë me numër 1329 i datës 18.10.2017 nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti Ekonomik për [redacted]; Diplomë me numër 4775 i datës 15.12.2014 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për [redacted]; CV-ja e [redacted]; Letërnjoftim i J.B.; Certifikatë e datës 27.02.2019 nga Gjykata Themelore Prishtinë për [redacted]; Letër rekomandim me numër protokoll 171 i datës 01.04.2019 nga DRPR/MPB për [redacted]; Letër referencë e datës 18.10.2018 nga "UNDP" për [redacted]; Letër referencë e datës 14.04.2018 nga "UNDP" për [redacted]; Vërtetim me numër protokoll 545 i datës 02.08.2018 nga DFSHP/MPB për [redacted]; Raporti i vlerësimit të punës praktike me numër protokoll 504 i datës 01.08.2018 nga DRPR/MPB për [redacted]; Vërtetim i datës 06.01.2014 nga N.SH. "Te Baci" për [redacted]; Raport i vlerësimit të punës i datës 06.01.2014 nga N.SH. "Te Baci" për [redacted]; Referencë e datës 09.01.2017 nga SH.P.K. "Beda" për [redacted]; Vërtetim i datës 15.11.2014 nga ATK për [redacted]; Certifikatë nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave e datës 15.11.2013 për [redacted]; Certifikatë e datës 10.12.2018 nga DRPR/MPB për [redacted]; Certifikatë e datës 21.04.2015 nga "AFAS" për [redacted]; Certifikatë e vitit 2015 nga "Expik" për [redacted]; Certifikatë e datës 13.07.2013 nga "Kujtesa" për [redacted]; Certifikatë me numër 748 e datës 01.07.2014 nga "Zas trade" për [redacted]; Certifikatë me numër 308 e datës 17.12.2010 nga "Zas trade" për [redacted]

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted], është pjesërisht e bazuar, SEPSE:

Ankuesja në ankesë e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Prot: 127 të datës 25.05.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, pretendon se në këtë procedurë ka pasur shkelje procedurale dhe materiale ngase kandidatët e suksesshëm nuk plotësojnë kushtet e konkursit dhe me këtë nuk janë respektuar dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil; Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.Prot: 127 të datës 25.05.2021 nuk ka shqyrtuar fare aplikacionet e kandidateve dhe nuk ka eliminuar shkeljet e konstatuar me Vendimin A.nr.216/2021 të datës 05.05.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, referuar konkursit të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës, për pozitën "Inspektor Tatimor-20 pozita", ka konstatuar se kriteret e konkursit, kanë qenë: *"Diplomë universitare në Fakultetin Ekonomik, Juridik apo të Biznesit, Së paku 3 (tri) vite përvojë pune profesionale...Të mos ketë dosje penale (të vërtetuar më certifikatë nga gjykata kompetente)".*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në kriteret e konkursit dhe në të gjitha provat e lëndës të dërguara nga ankuesja dhe Administrata Tatimore e Kosovës, ka

shqyrtuar me shumë dosjen e ankueses dhe kandidatëve të përzgjedhur duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil nuk ka marr parasysh kriterin e konkursit *“Të mos ketë dosje penale (të vërtetuar me certifikatë nga gjykata kompetente”*, sepse në bazë të dosjeve të disa prej kandidatëve të përzgjedhur si: _____ në dosjet e tyre nuk

kanë certifikatën nga gjykata kompetente përmes të cilat do të vërtetohej se kanë apo nuk kanë dosje penale, e në këtë kuptim aplikacionet e këtyre kandidatëve kanë qenë të pa kompletuara dhe mbi bazë të dispozitave ligjore aplikacionet e pa kompletuara duhet refuzuar siç parashihet me dispozitat e nenit 25 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ngase një dokument i tillë ka qenë kriter i konkursit.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar provat e lëndës, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, në listë të shkurtër respektivisht ka rekomanduar si kandidatë të suksesshëm kandidatin _____ të cilët në aplikacionin e tyre posedojnë Pasqyrën e Llogarisë nga Trusti por nuk posedojnë vërtetime të përvojës së punës të lëshuara nga institucionet ku kanë punuar, e të cilat do të dëshmonin se e ka përvojën e punës siç kërkohet me konkurs, ngase me dispozitat ligjore të aplikueshme ka qene e përcaktuar se kandidatët me rastin e aplikimit kandidatët duhet të dërgojnë edhe kopjet e dëshmisë së punësimit siç parashihet me nenin 21 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin plotësues si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore të bashkangjitura në aplikacion, kopjet e dëshmisë së punësimit (për kandidatët të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil)...”*, ngase Kolegji i Këshillit, konstaton se dëshmia e pasqyrës së pagesave në fondin për kursime pensionale është dokument i pranueshëm dhe i cili vetëm e përforcon dëshminë e përvojës së punës, mirëpo pasqyra e pagesave në fondin për kursime pensionale nuk është dokument i cili pasqyron në mënyrë të detajuar pozitën që është duke e ushtruar pala dhe ky dokument është detyrim ky ligjor i përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, mirëpo kandidati me rastin e aplikimit bashkërisht me dokumentin e pagesave në fondin e kursimeve pensionale është dashur të bashkëngjis edhe dëshminë e përvojës së punës konkretisht vërtetimin e përvojës së punës të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit e që është dokument primar, kështu që Kolegji i Këshillit, konstaton se aplikacioni i këtij kandidati ka qenë i pa kompletuar dhe i njëjti është dashur të refuzohet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka përfshirë në listën e shkurtër respektivisht ka rekomanduar kandidatin Pajtim Grainca i cili në bazë të Certifikatës së datës 29.03.2019 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj është dënuar me Aktgjykim të formës së prerë me numër P.2081/17 me 800 Euro i cili aktgjykim ende nuk është ekzekutuar, në këtë kuptim është vepruar në kundërshtim me nenin 25 paragrafit 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Aplikacionet e kandidatëve, të cilët kanë dosje kriminale, e cila sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil konsiderohet e papërshtatshme për emërim në Shërbimin Civil, do të refuzohen”*, po ashtu në bazë të dosjes së këtij kandidati i njëjti nuk ka dëshmi të përvojës së punës prej 3 (tri) vitesh pasi që posedon Vërtetimin e datës 01.04.2019 të lëshuar nga SIGAL ku ka punuar nga data 01.06.2016 deri më datë 31.08.2016, Referencën nga

FISI COM SHPK ku ka punuar nga data 01.02.2014 deri 30.06.2015 (para diplomimit), po ashtu i njëjti posedon një shkresë ku thuhet "Pagat sipas Trustit" që nuk është dokument zyrtar i Trustit Pensional të Kosovës dhe këtë dëshmi në këtë shkresë nuk e ka të mbuluar më asnjë vërtetim nga institucioni përkatës përvojën e punës së kërkuar me konkurs, në këtë kuptim përfshirja e tij në listën e shkurtër respektivisht përzgjedhja e tij është në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Në kuptim të nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala"*, dhe bazuar në gjetjet e Gjykatës së Apelit të Kosovës, sipas Aktgjykimit AA.nr.401/20 të datës 16.06.2022 dhe Aktgjykimit AA.nr.402/20 të datës 16.06.2022, Kolegji i Këshillit, bazuar edhe në vendimmarrjen sipas Vendimit A.nr.616/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për objektin e njëjtë (për konkursin datës 13.06.2017 për Inspektor Tatimore për 30 pozita), konstaton se Njoftimi për kandidatët e suksesshëm me numër protokollit 205 i datës 13.05.2019 i shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës për procedurën e rekrutimit për pozitën Inspektor Tatimor 20 pozita ndryshohet në mënyrë që kandidatët që nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit, konkretisht atë të përvojës së punës pas diplomimit dhe kriterëve të tjera duhet të largohen nga lista përfundimtare për kandidatët e suksesshëm, ndërsa kandidatët që kanë plotësuar kushtet mbesin në listën përfundimtare të kandidateve të suksesshëm, kështu që pretendimet ankimore të ankueses sa i përket kësaj çështje janë pjesërisht të bazuara.

Lidhur me Vendimin me Nr. Prot: 127 i datës 25.05.2021 të Komisioni Ad Hoc për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës përmes të cilit është refuzuar ankesën e ankueses dhe është lënë në fuqi Vendimit me Nr. 11/107 i datës 10.06.2019 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase Vendimi Vendimit me Nr. 11/107 i datës 10.06.2019 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës është shfuqizuar sipas Vendimit A.nr.216/2021 të datës 05.05.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe mbi këtë bazë në rast se Këshilli shfuqizon një akt administrativ i njëjti nuk mund të lihet në fuqi nga një organ i shkallës më të ulët, në këtë kuptim nuk është zbatuar vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke u shkelur dispozitat e nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Bazuar në këtë konstatim si dhe bazuar në Vendimin A.nr.216/2021 të datës 05.05.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës ka qenë i obliguar që të eliminoj shkeljet procedurale në këtë procedurë dhe në fazën e ri procedurës të veproj në përputhje me pikëpamjet e këtij vendimi dhe në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa në rastin konkret Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot: 127 i datës 25.05.2021, nuk ka eliminuar shkeljet procedura dhe në bazë të fakteve vendimtare ka vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjor në fuqi të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, rrjedhimisht ky vendim është në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe i njëjti është i paligjshëm sipas nënti 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të këtij ligji, sepse nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike, ndërsa pretendimet ankimore të ankueses ndaj këtij vendimi janë te bazuara.

Andaj nga konstatimet si më lartë dhe bazuar në dispozitivin e këtij vendimi, Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, janë të obliguar që të zbatoj këtë vendim si në dispozitivin e tij.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.568/2021

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses avokatit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivoit të KPMSHCK-së.